



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.572/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc, kryesues, Rustem Thaçi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Sevdije Qestaj me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.572/2021 i paraqitur nga Sevdije Qestaj me vendbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

### A r s y e t i m

Me datën 31.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Sevdije Qestaj me vendbanim në Gjermani, në të cilin pretendon se KQZ-ja, nuk e ka përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës për arsye se siç thekson ajo ka aplikuar nga adresa e kumatit të saj. E njëjta kërkon nga PZAP-i, që ti mundësohet, përfshirja në listën e votuesve jashtë Kosovës. Si dëshmi ka bashkangjitur emailin nga KQZ me të cilën është njoftuar se iu është refuzuar aplikacioni, kopjen e emailit me të cilën ka aplikuar, formularin e aplikimit si dhe dokumentin e identifikues (pasaportën) në emër të saj.

Me datë 31.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 01.09.2021 në ora 09:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se lidhur me këtë apel të parashtruar nga Sevdije Qestaj, është aplikuar nga email adresa elektronike [isuf\\_qestaj@outlook.com](mailto:isuf_qestaj@outlook.com), siç shihet edhe në ankesat paraprake të aplikuesve me mbiemër Qestaj me vendbanim në Zvicër, i njëjti email adresë ka dërguar aplikacione për personat me mbiemrin Qestaj, që kanë vendbanim në shtetin Gjermanisë.

Në vazhdim të përgjigjes theksohet se si të tilla, dërgimi i aplikacioneve për regjistrim pavarësisht se është i njëjti mbiemër, e që janë dërguar nga e-mail adresa "[isuf\\_qestaj@outlook.com](mailto:isuf_qestaj@outlook.com)" nuk konsiderohet rreth i ngushtë familjarë, për shkak që të gjitha aplikacionet e dërguara tashmë nga ky e-mail, janë aplikacione për persona që kanë vendbanim në Zvicër dhe Gjermani, e në data bazën e aplikimit për regjistrim, rezulton se është edhe një mbiemër Qestaj, me vendbanim në Suedi, dhe për këtë arsye janë refuzuar që të gjithë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimt, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit Sevdije Qestaj gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka bërë aplikim për regjistrim përmes Isuf Qestaj dhe i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi me të cilin e vërteton faktin se Isuf Qestaj ka pasur autorizim për të aplikuar në emër të apellesit. Paneli gjithashtu ka

konstatuar se edhe pse aplikimi është bërë për persona me mbiemër të njëjtë dhe që nuk kanë vendbanim të njëjtë, kjo nuk e vërteton faktin se të njëjtit janë familjar pasi që në rastin konkret nuk është ofruar asnjë provë që dëshmon se të njëjtit janë në lidhje të ngushtë familjare, andaj edhe emri i tij nuk figuron në bazën e të dhënave të KQZ-së për votuesit jashtë Kosovës, meqenëse nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkojnë në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: “*çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës*”, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: “*votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil*” dhe dispozita e nenit 3.3 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

*3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:*

*a) formularin për Aplikim/Regjistrim për votim jashtë Kosovës, kopja e së cilës është bashkangjitur si Shtojcë II, dhe,*

*b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,*

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura si më lartë, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret ankuesi thënie të tij nuk i mbështetën në asnjë provë konkrete por se të njëjtat janë supozime dhe se këto pretendime ankuesi nuk i argumenton me asnjë provë.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Sevdije Qestaj nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje e pretenduar. Paneli vlerëson se vetëm mbiemri nuk është i mjaftueshëm për te konstatuar se aplikimet janë brenda rrethit të ngushtë familjar, ndërsa nga tërësia e shkresave nuk rezulton se ka një autorizim për aplikim nga personi tjetër përkundër se është me mbiemrin e njëjtë, rrethi i ngushtë familjar po ashtu nga adresa nuk rezulton se aplikuesi ka një vendbanim me parashtruesin e apelit e që në kuptim të rrethit të ngushtë familjar nuk ka ndonjë prove që ka mbështetur apelin për ta provuar faktin e ekzistimit të afërsisë së tyre familjare, rrjedhimisht nga të gjitha këto paneli nuk mund të vërtetojë faktin se aplikuesi është në rrethin e ngushtë familjare me parashtruesin e Apelit.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 572/2021 më datën 02.09.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.